



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË
KRYETARI I KËSHILLIT

Nr 544 Prot

Gjirokastër më 24 : 01 :2024

Lënda: Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Gjirokastër date, 31.01.2024

Z/Znj. _____

GJIROKASTËR

Në zbatim të ligjit Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 53, si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak, ju njoftoj se mbledhja e Këshillit Bashkiak do të zhvillohet në **datë, 31.01.2024, ora: 12:00 pranë universitetit "Eqrem Çabej"** me rendin e ditës si vijon.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 14. 12.2023. dhe mbledhjes jashte 29.12.2023.
2. P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.01. 2024**".
3. P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.01. 2024**".
4. P/ Vendim "Për miratimin e kritereve për përdorimin e fondit të buxhetit vendor, për familjet dhe individët në nevojë që rezultojnë me pikë të pamjaftueshme nga sistemi i pikëzimit për vitin 2024".
5. P/Vendim "Për miratimin e kritereve për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për bllok- ndihmën ekonomike deri ne 6%, për familjet dhe individët në nevojë që rezultojnë me pikë të pamjaftueshme nga sistemi i pikëzimit"
6. P/Vendim "Miratimin e vlerës si dhe të listës së 20 përfituesve për programin e subvencionit të qirasë nga fondet e buxhetit të shtetit në vlerën 2.112.000lekë/vit dhe 908.400 lekë/vit nga bashkia Gjirokastër.
7. P/Vendim "Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore/dimërore që do të kontraktohen për përdorim me qira për kullotje për sezonin veror 2024 dhe sezonin dimëror 2024-2025".
8. P/Vendim "Për miratimin e dhënies së sipërfaqeve të tokave bujqësore me qira".
9. P/Vendim "Për miratimin e të Ardhurave Afatmesme 2025-2027 në bashkinë Gjirokastër"
10. Të ndryshme.

KRYETARI KËSHILLIT
Merita ISARAJ

